



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më ____ . ____ .2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mbikqyrje punimesh për objektin: “Rindërtimi në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit (Pallate), pallati nr.3 dhe pallati nr.4 në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71247000-1 (Shërbime).

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,094,149.51 (tre milion e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë pikë pesëdhjetë e një) lekë.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e Ligjit,Nr.9,date 16.12.2019, te Keshillit te Ministrave, “Per perballimin e pasojave te fatkeqsise natyrore” , Vendimit Nr. 225, date 12.04.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per procedure e prokurimit “Procedure e pershpejtuar”, për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte të tenderit “Procedure e pershpejtuar Shërbime” dhe konkretisht të llojit “Tender i kufizuar ne kuader te rindertimit” te miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetëdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kurbini** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Kjo shtojce do paraqitet në fazën e II)*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;* Ofertuesit duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerë së përafërt të kontratës, të përcaktuar në dokumentet e tenderit 61,882 (gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) Lekë

ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

- d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;
- e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.
- ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës është nën kufirin e ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar te ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar**, ku bilancet e kerkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur.

(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2022 për secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në

ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontrates eshte nen kufirin e ulet monetar. Vlera per pune te ngajshme perben nje nivel te mjaftueshem pervoje duke patur parasysh objektin dhe vleren e kontrates.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise bazuar ne formatin e

miratuar me Vendim te Keshillit te Ministratve Nr.943,date 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqytjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", si më poshtë:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP - 1 Punime gjurmimi në tokë
- NP - 2 Ndërtime civile dhe industriale
- NP - 3 Rikonstrukcion dhe Mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- N.P – 7 Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje
- NP - 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- N.S. - 1 Punime për prishjen e ndërtesave
- NS - 2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina
- NS – 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to
- NS - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS - 14 Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj
- NS - 18 Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendim te Keshillit te Ministratve Nr.943,date 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqytjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

<i>KATEGORIA E KERKUAR</i>	<i>PERSHKRIMI I KATEGORISE</i>
NP – 1	<p>Punime gjurmimi në tokë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit do të ketë punime gjurmimi</p>

NP - 2	<p>Ndërtime civile dhe industriale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit do të rikonstruktohet godina ekzistuese me riaftësim strukturor.</p>
NP - 3	<p>Rikonstruksion dhe Mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada</p> <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit ka zëra pune që lidhen me rikonstruksion të objektit ekzistues, ndërhyrje me fasada dhe telajo metalike dhe struktura beton arme, rikonstruksion, riaftësim përforcim</p>
NP - 7	<p>Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje - ---</p> <p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.</p> <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit janë parashikuar zëra pune të kategorisë Punime KUB, të cilat shtrojnë të nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.P-7, me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar ujësjellësit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.</p>
NP -12	<p>Punime të inxhinierisë mjedisore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të

	<p>veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike,</p> <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit janë parashikuar zëra pune të cilat afektojnë në mënyrë të drejtperdrejt dhe të terthorte ndikimin në mjedis.</p>
PUNIME SPECIALE NDERTIMI	
NS - 1	<p>Punime për prishjen e ndërtesave</p> <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit janë parashikuar zëra për të kategorisë prishje punimesh</p>
NS - 2	<p>Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit është parashikuar ristrukturim i impianteve ezistuese dhe ndertimi i impiantit kundër zjarrit, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Përfshin konkretisht mbrojtjen antizjarr dhe sistemet si dhe furnizimin e ambineteve me ujë sanitar</p>
NS - 4	<p>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me

	<p>dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.</p> <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit janë parashikuar punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues.</p>
NS - 12	<p>Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit parashikuar montimi dhe mirëmbajtje, ristrukturimi i një sistemi të plotë, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.</p>
NS - 14	<p>Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit është parashikuar Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.</p>

NS - 18	<p>Punime topogjeodezike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh <p>Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike (shpime e punime shtresash) që lidhen ngushtesisht me natyrën teknike të realizimit të rikonstruksionit të objektit dhe gjithashtu ndertimit të objekteve të reja është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.</p>
---------	--

2.3.3 A. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor (Drejtues Teknik)** të përfshirë në licensën e shoqërisë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale dhe të vërtetuar në listpagesa per Periudhen **3 (tre) muajt e fundit**, si më poshtë:

- a) 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- b) 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- c) 1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- d) 1 (një) Inxhinier Elektrik
- e) 1 (një) Inxhinier Mjedisi / Kimist Teknolog
- f) 1 (një) Inxhinier Mekanik
- g) 1 (një) Arkitekt

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Gjithashtu sqarojme se kemi të bëjmë me mbikqyrjen e objektit (i cili po rindërtohet që të jete i qëndrueshëm nga tërmeti) prandaj është i domosdoshëm ky numer inxhinieresh drejtues teknik. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Drejtuesi i

projektit është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

B. Operatori ekonomik duhet të disponojë **staf mbështetës** vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/certifikatë dhe të vërtetuar në listpagesa ose të kontraktuar, si më poshtë:

- 1 (një) Ekspert zjarrfikës
- 1 (një) Ekspert mjedisi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

C. Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

1 (nje) punonjës përgjegjës, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jetë i pajisur me certifikatën për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i cili duhet të figurojë në listepagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton

kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 (dhjetë) persona** per periudhen **3 (tre) muajt e fundit** e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve etj dhe është nxjerr numri total i punonjësve që nevoiten për të kryer këto mbikëqyrje. Gjithashtu sqarojmë se kemi të bëjmë me mbikëqyrjen e objektit (i cili po rindërtohet që të jetë i qëndrueshëm nga tërmeti) prandaj është i domosdoshëm ky numer punonjësish. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Në numrin total të punonjësve të kërkuar janë përfshirë edhe stafi inxhinierik i kërkuar në license si dhe stafi mbështetës me kualifikimet perkatese që një firmë serioze ka. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

A. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira instrumentat topografike si me poshte:

- Pajisje GPS Rover 1 (nje) copë;
- Pajisje Total Station 1 (nje) copë;

Në lidhje me sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë Qiraje të noterizuar (original).

B. Kandidati/ ofertuesi për realizimin e kontratës duhet të disponojë të pakten 1 (nje) mjet transporti të specialistëve. Për të veretuar këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Për të dëshmuar këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat e mëposhteme:

1. Për mjetet në pronësi që shenohen në Regjistrat publike, duhet të paraqiten dokumentat që veretojnë rregjistrimin e mjetit si: Leje Qarkullimi, Siguracionin e mjetit dhe Çertifikatën e Kontrollit teknik.
2. Për mjete të marra me qera dokumentave të mesipërme të bashkëlidhura me Kontrata perkatëse të qerave / leasing / huapërdorjes, të jenë të lidhura para noterit dhe brenda afatit të objektit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesipërme janë vendosur në përputhje me natyrën e punimeve dhe volumnin e punimeve të percaktuar në preventivin e punimeve.

Numri i paisjeve dhe i makines së transportit janë vlerësuar si të nevojshme në përputhje me natyrën e kontratës, duke iu referuar, kohezgjatjes së punimeve.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mesipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- a) Çertifikate ISO 9001-2015 ”Për sistem menaxherial të cilësisë”, të vlefshme ose ekuivalente.
- b) Çertifikate ISO 14001-2015 ”Për sistem menaxherial të mjedisit”, të vlefshme ose ekuivalente.
- c) Çertifikate ISO 45001-2018 ”Për sistem menaxherial të shëndetit dhe sigurisë në punë”, të vlefshme ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është percaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë

standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Ne rast se oferta është me e ulët se minimumi i përcaktuar në këtë vendim ajo do të skualifikohet. Ky kriter bazohet në rekomandimin e APP-se me shkresat Nr.5585 Prot. me datë 25.07.2017. Ofertuesit duhet të plotësojnë në mënyrë rigorozë ofertën sipas shtojcës 1. Ofertuesit në përgatitjen e ofertës duhet të kenë parasysh që të mos tejkalojnë vlerën e fondit limit për çdo projekt. Mosplotësimi i saktë i kësaj oferte përben kusht për skualifikim. *(Do paraqitet në fazën e II)*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Jane hedhur se bashku me dokumentat teknike të tenderit ku janë shprehur qartë kërkesat AK për cilësinë e të gjithë punimeve dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e kontratës.

Shënim: *Per me shume informacion rreth dokumentacionit, referohuni procedurës me numër referencë: **REF-49536-11-10-2022**, me objekt: “Rindërtimi në truallin ekzistues të 2 (dy) njësisë të banimit (Pallate), pallati nr.3 dhe pallati nr.4 në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”, të cilën e keni në SPE të APP-së.*

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Benard Palaj Anëtar
3. Elvis Guraj Anëtar